



UNMIK/REG/2008/17
26 mars 2008

RREGULLORE NR. 2008/17

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UT NR. 2005/54 MBI
KORNIZËN DHE PARIMET UDHËZUESE TË SHËRBIMIT POLICOR
TË KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999, mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Duke marrë parasysh, mes tjerash, Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe të Lirive Fundamentale dhe Protokollet e saj dhe Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ci vile dhe Politike dhe Protokollet e saj,

Pas konsultimit të Qeverisë dhe marrjen e pëlqimit të saj,

Me qëllim të ndryshimit të Rregullores nr. 2005/54 që të parasheh themelimin e një bordi të pavarur për të rregulluar standardet e trajnimit dhe të punësimit për profesionistët e shërbimit civil të cilët punojnë në fushat që janë të lidhura me sigurinë publike, si dhe themelimin e Qendrës kosovare mbi zhvillimin dhe arsimimin në sigurinë publike si Agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme për drejtimin e trajnimit të tillë,

Me anë të kësaj shpall si vijon:

Neni 1
Ndryshimet

Nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, neni 8 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/54 ndryshohet si vijon:

“Neni 8
Trajnimi dhe arsimimi i policisë

8.1 Me një rregullore tjetër të shpallur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm themelohet Bordi kosovar mbi standardet e sigurisë publike dhe arsimin (më tutje: Bordi). Bordi do të jetë bord profesional mbi standardet dhe arsimin dhe do të jetë përgjegjës, mes tjerash, për përcaktimin e të gjitha standardeve minimale të detyrueshme mbi arsimin dhe për programet mbi shërbyesit civil të cilët punojnë në fushat që lidhen me sigurinë publike, duke përfshirë edhe policët. Të gjitha programet e detyrueshme do të certifikohen nga Bordi.

8.2 Ministri i Punëve të Brendshme do të nxjerrë udhëzime për Zëvendëskomisionerin e Policisë së SHPK-së mbi trajnimin dhe arsimimin e policëve. Sipas atyre udhëzimeve dhe në bashkërendim me Komisionerin e Policisë, si dhe në pajtim me standardet e certifikuara nga Bordi, Zëvendëskomisioneri i Policisë i SHPK-së do t’i shfrytëzojë ato udhëzime për caktimin dhe drejtimin e programe adekuate për trajnim për të gjithë policët dhe stafin mbështetës të policisë.

8.3 Komisioneri i Policisë do të jetë anëtar i Bordit sipas detyrës zyrtare, dhe si i tillë do t’i ushtrojë funksionet e tij në konsultim me Ministrin e Punëve të Brendshme.

8.4 Qendra kosovare për zhvillim dhe arsimim në sigurinë publike (më tutje: “QKZHASB”), aktualisht Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës e OSBE-së në Vushtrri, do të jetë Agjenci ekzekutive e pavarur e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Bordit do t’i ofrojë shërbime për Sekretariatit dhe shërbime të tjera mbështetëse. QKZHASB do të jetë lokacioni primar për trajnime policore bazike dhe të specializuara.

8.5 QKZHASB do të menaxhohet nga një kryeshf ekzekutiv, i cili do të jetë shërbyes civil në kuptim të nenit 1(j), (ii) të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/36, dhe do të emërohet nga Komisioni për emërimet të larta publike, në pajtim me ligjin në fuqi. Funksionet dhe përgjegjësitë e

3
kryeshefit ekzekutiv do të paraqiten në një urdhëresë
administrative të mëvonshme.”

Neni 2
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 26 mars 2008.

Joachim Rücker
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm